



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.11.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Prezantimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Robert Bitri, Tatiana Nurçe, Gjetan Gjetani, Ilir Ndraxhi, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Halit Valteri, Nimet Musaj, Kujtim Gjuzi, Klajdi Qama, Zef Shtjefni dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Lefter Koka dhe Andrea Marto.

Të ftuar:

Bledi Çuçi - Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Enea Hoti - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Irfan Tarelli - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Arian Jaupllari - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Agron Vata - Drejtor i Drejtorisë së Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të datës 18.11.2019, e cila ishte planifikuar për orën 12:00, por tani ora është 12:18.

Sot kemi prezantimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020” për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Sot të ftuar kemi ministrin, i cili do të na e prezantojë buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Pasi kemi dëgjuar ministren e Financave dhe Ekonomisë lidhur me këtë projektligj, dhe pasi kemi bërë pyetjet dhe diskutimet e nevojshme, sot do të vazhdojmë me Ministrinë e Bujqësisë, një tjetër sektor shumë i rëndësishëm me një kontribut të madh, më të madhin e PBB-së.

Pa humbur kohë fillojmë me një prezantim të projektligjit nga ana e ministrit, të cilit i uroj mirëseardhjen, si dhe përfaqësuesve të ministrisë. Më pas do të vazhdojmë me pyetje dhe diskutime nga ana e anëtarëve të komisionit.

Zoti Ministër, fjala për ju.

Blendi Çuçi – Faleminderit kryetar,

Të nderuar deputetë,

Trendi pozitiv i rritjes së sektorit të bujqësisë, falë politikave të qeverisë, ka vijuar edhe në vitin 2019. Mbetet fakt që bujqësia është sektori që kontribuon më shumë në GDP-në e Shqipërisë me mbi 20%. Bujqësia po orientohet dhe po mbështetet drejt produkteve me avantazhe konkurruese dhe krahasuese me plotësimin e nevojave të tregut të brendshëm dhe atë të eksportit, kryesisht me pemë frutore, perime, bimë medicinale e të tjera. Treguesi më domethënës i ecurisë pozitive është raporti import-eksport i produkteve bujqësore që kemi sot, i cili përgjatë vitit 2019 ka qenë rreth 1 me 3, pra 1 eksport dhe 3 import. Duhet thënë se gjatë këtij vitit ka zbritur edhe nën 3. E përmend këtë, sepse është një zbritje historike, pasi kurrë nuk ka qenë në këtë raport gjatë 30 vjetëve të fundit.

Në vitin 2019 kemi një rritje, krahasuar me vitin 2018, të eksporteve. Në 8-mujorin e vitit 2019 kemi pasur një rritje të përgjithshme me rreth 12% të prodhimeve bujqësore, si dhe me rreth 24% të prodhimeve që janë përgjithësisht të sektorit të bujqësisë, por duke përfshirë edhe blegtorinë dhe peshkimin. Pra, vetëm për eksportin e fruta-perimeve biomedicinale kjo rritje ka shkuar në 24%. Duhet të theksoj se mbështetja financiare për sektorin bujqësor në vitin 2019 arriti në një moment deciziv me hapjen e programit të IPARD –it me një total rreth 94 milionë euro në dispozicion, pra 71 milionë euro ishin financim nga BE-ja dhe 23 milionë nga buxheti i shtetit. Ky program ka ecur shumë mirë deri tani, krahasuar me thirrjet e para

që kanë pasur vendet e rajonit në lidhje me IPARD-in. Deri tani kemi nënshkruar 53 kontrata me një buxhet prej 10 milionë eurosh, por pritet të nënshkruhen mbi 100 kontrata. Në fillim të muajit nëntor ne kemi hapur thirrjen e dytë për aplikimet e IPARD-it.

Lidhur me skemat kombëtare, në vitin 2019 fokusi ka qenë kryesisht te sektori i blegtorisë, kjo edhe për shkak të një situatë që krijoi ulja e TVSH-së së rimbursueshme për sektorin nga 20% në 6% duke e subvencionuar, pra duke mbështetur qoftë për tufat, qoftë mbështetja që bëme për litër qumështi, por edhe në sektorin e ullirit.

Me buxhetin faktik prej 825 milionë lekësh, që e shtuam me aktin normativ që sapo e miratuam në parlament, numri total i fermerëve që përfitojnë nga mbështetja pritet të jetë 5 mijë.

Risi për këtë vit ka qenë edhe mbështetja e kërkimit shkencor në bujqësi, duke i akorduar Universitetit Bujqësor të Tiranës rreth 125 milionë lekë për ndërtimin e fermës didaktike. Gjithashtu, gjatë këtij viti një impakt shumë pozitiv për zhvillimin e këtij sektorit kanë dhënë ndryshimet e bëra në paketën fiskale. Këtu dua të përmend heqjen e TVSH-së për inputet bujqësore, ku përfshihen: plehurat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët; heqjen e TVSH-së për makinat bujqësore si në import, ashtu edhe brenda vendit; heqjen e pragut të xhiros për efekt rimbursimi të TVSH-së dhe reduktimin e tatim-fitimit në 5% për shoqëritë e bashkëpunimit, që operojnë në fushën e bujqësisë, si dhe paketa e agroturizmit për subjektet e certifikuara si agroturizëm, ku kemi 6% TVSH, 5% tatim-fitimi dhe 0% taksë të ndikimit në infrastrukturë.

Për sa i përket shtyllës tjetër që lidhet me veterinarinë dhe me sigurinë ushqimore, në vitin 2019 vërehet eliminimi i rasteve të sëmundjeve të dermatozës nodulare të kafshët, ku nuk ka pasur asnjë rast si në vitin 2018, ashtu edhe në vitin 2019, kundrejt 49 rasteve që kemi pasur në vitin 2017. Strategjitë e miratuara nga ministria kanë rezultuar efikase në luftimin e sëmundjeve zontike.

Vaksinimi për sëmundjen e brucelozës ka shkuar në 510 mijë krerë. Vaksinimi kundër sëmundjes së plasjes ka shkuar mbi 75 mijë gjedhë dhe të imta; mbi 300 mijë gjedhë të vaksinuara për dermatozën nodulare. Gjithashtu, janë forcuar më shumë kapacitetet laboratorike të ISUR-it; është rritur me 50% numri i analizave të kryera; janë zhvilluar 12 metoda të reja, duke rritur numrin e shërbimeve në 130 tregues analitikë, duke e çuar numrin në 537 tregues në total; janë mirëmbajtur 53 teste të akredituara dhe janë dërguar 42 teste të reja për akreditim, që do ta çojnë numrin total të testeve të akredituara në 95.

Për AKU-në synohet rritja e kapaciteteve të performancës së institucionit. Ne sapo e kemi kaluar në qeveri dhe shumë shpejt do ta sjellim këtu për miratim projektligjin për

ndryshime në ligjin e ushqimit, ku do të realizohen një sërë reformash institucionale dhe riorganizim total të AKU-së, madje duke i shtuar edhe funksionet e tjera nga Inspektorati i Shëndetësisë, duke përmirësuar edhe sistemin e apelimit të gjobave.

Në buxhetin e vitit 2019 në lidhje me investimet në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit dhe mbrojtjes nga përmytja, në total ishin 3,52 miliardë lekë, nga të cilat 2,83 miliardë lekë për investime dhe 0,69 miliardë lekë për shpenzime të tjera. Me këto para janë mundësuar investime në 31 projekte të ujitjes, duke përmirësuar ujitjen e rreth 5 mijë hektarë tokë vetëm brenda këtij viti, ndërsa me përfundimin e tyre në vitin 2020 sipërfaqja do të jetë 18 mijë hektarë me përfitues rreth 20 mijë familje fermere.

Investimet kanë qenë të mëdha në 8 projekte për rezervuare; në 18 objekte për mbrojtjen nga përmytja; në rehabilitimin dhe ndërtimin e rreth 22 kilometrave argjinatura mbrojtëse; në sistemin e rreth 8 kilometrave të lumenjve të ndryshëm.

Për sa i përket ujitjes dhe kullimit, po të krahasojmë vitin 2013 me vitin 2019 kemi totalisht një panoramë tjetër. Në vitin 2013 janë ujitur 120 mijë hektarë tokë, kurse sot, falë investimeve që janë bërë në gjithë këta vjet, ujitjen 245 mijë hektarë tokë. Nga 90 mijë hektarë tokë të kulluar që kishim, sot kemi 235 mijë hektarë tokë të kulluar. Në vitin 2018 kemi bërë të mundur rehabilitimin e 20 kilometrave argjinaturë, kurse në vitin 2019 kemi 85 kilometra.

Dua të them dy fjalë edhe për peshkimin.

Në vitin 2019 me fondet e ministrisë kemi mundësuar investimin e markatës së peshkut të Shëngjinit; ripopullimin me rasat dhe peshk në liqenin e Ohrit, Fierzës dhe Prespës; kalimin në menaxhim të portit të Durrësit tek Organizata e Menaxhimit të Peshkimit dhe miratimin e investimeve në këtë port nga kjo organizatë.

Unë ju bëra një paraqitje shumë të shkurtër të arritjeve kryesore, që kemi pasur për sa i përket zbatimit të politikave buxhetore të vitit 2019 për të ardhur te prezantimi për vitin 2020.

Buxheti i vitit 2020 në terma financiarë është rreth 11,4 miliardë lekë ose 15% më i lartë se në vitin 2019. Theksoj se viti 2020 është një vit rekord për buxhetin e bujqësisë dhe, po ta krahasojmë me vitin 2013, ky buxhet ka qenë 6,7 miliardë lekë, kurse sot është 11,4 miliardë lekë, pra rreth 70% më i lartë.

Raporti i investimeve nga buxheti i shtetit (edhe nga viti 2018 është e me rritje, siç jua thashë, është 11,4 miliardë lekë apo 15% më i lartë se viti 2019) në bujqësi për vitin 2020, krahasuar me vitin 2013, është 37% më shumë, pra kemi bërë 3,7 herë më shumë investime në sektorin e bujqësisë në këta vjet që po flasim, prandaj kemi edhe këto rezultate.

Për sa u përket programeve për vitin 2020 (siç jua thashë totali është 11,4 miliardë me një rritje prej 15%), kemi programin "Shpenzime dhe fonde pagash" me një rritje të vogël 2%, pra është 1,8 miliardë; kemi programin "Shpenzime operative" me një rritje 16%, pra rreth 2,5 miliardë; kemi programin, "Investimeve të brendshme" me vlerë 3,3 miliardë dhe një rritje nga viti 2019 me 16%; kemi edhe programin "Investime të huaja" me një rritje 22% nga viti 2019 me një shifër rreth 3,7 miliardë lekë.

Buxheti i vitit 2020 për sektorin e bujqësisë do të mbështesë disa reforma thelbësore dhe më konkretisht reformën në sektorin e veterinarisë, ku kemi përgatitur një kuadër ligjor tërësisht të ri për ta riorganizuar shërbimin; do të mbështesë ristrukturimin total të AKU-së, siç jua thashë, duke bërë ndryshimet përkatëse; do të ketë mbështetje financiare për skemën e IPARD-it qoftë nëpërmjet kontributit buxhetor, qoftë nëpërmjet skemës kombëtare; do të ketë investime në infrastrukturën bujqësore dhe sigurinë ushqimore. Në total buxheti për investimet në infrastrukturë është rreth 3,16 miliardë lekë nga të cilat 2,45 miliardë lekë investime dhe 0,71 miliardë lekë shpenzime. Në ujitje kemi një financim me rreth 563 milionë lekë, nga të cilat rreth 420 milionë lekë do të përdoren për vazhdimin e financimit dhe përfundimin e punimeve në 22 skema ujitëse të bashkive, të cilat, ndërkohë, kanë filluar që në vitin 2019. Gjithashtu, do të bëjmë edhe rehabilitimin e disa skemave ujitëse në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Këtu është skema ujitëse për rezervuarin e Doftisë në Gjirokastrë, skema ujitëse e Armenit për Bashkinë Selenicë, kanali ujitës i Postribës në Bashkinë e Shkodrës dhe kanali i ujitjes U13 në Bashkinë e Kurbinit.

Impakti që presim është përmirësimi i ujitjes për rreth 17 mijë hektarë, nga të cilat 13 mijë hektarë janë nga përfundimi i rehabilitimit të 22 skemave ujitëse të bashkive. Me financim të huaj janë parashikuar rreth 755 milionë lekë, me projektin e burimeve ujore dhe ujitjes nga Banka Botërore, pra një projekt i Bankës Botërore gjatë vitit 2020 do të përfundojë rehabilitimin e 7 skemave ujitëse, si vazhdim i vitit 2019: është dega e Çukasit në Lushnjë, skema e Leminotit në Maliq, skema e Sllanicës në Urën Vajgurore; skema Tregan 2 në Has, si dhe skema ujitëse e Janjarit, që shtrihet në Bashkinë e Konispolit, duke e çuar në 21 mijë hektarë sipërfaqen e rehabilituar nga projekti i Bankës Botërore. 258 milionë lekë do të përdoren për rehabilitimin e 8 digave, që janë objekte në vazhdim, të financuara pjesërisht në vitin 2019.

Në mbrojtje nga përmbytjet me financim prej 627 milionë lekësh parashikohet të ndërhyhet në rreth 15 objekte të mbrojtjes nga përmbytja, kryesisht në lumenjtë Shkumbin, Drini i Zi, Vjosë, Seman dhe Drino.

Rehabilitimi i kanaleve të ujërave të larta në zonat e Kurbinut dhe Mamurrasit, ku dhe kemi pasur problematikat më të mëdha nga reshjet në ditët e fundit. Këto ndërhyrje do të mundësojnë rehabilitimin apo edhe ndërtimin në disa raste të rreth 25 kilometrave argjinaturë mbrojtëse dhe sistemimin e rreth 27 kilometrave të kanaleve të ujërave të larta në Kurbin, duke minimizuar rrezikun nga përmbytja në zonat që i përkasin Bashkisë Lushnje, Bashkisë Dibër, Bashkisë Rrogozhinë, Bashkisë Fier, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Gjirokastrë, Bashkisë Berat, Bashkisë Kurbin e të tjera.

Në hidrovoqe rreth 60 milionë lekë janë për rikonstrukcionin e plotë të hidroforit të Cukës në Sarandë për garantimin e kullimit të rreth 900 hektarë tokë bujqësore.

Për sa i përket pjesës së punëve me shpenzime operative, ku kemi parashikuar rreth 458 milionë lekë, do të pastrohen rreth 235 kanale kryesore kulluese dhe rreth 65 kilometra kanale ujitëse, si dhe mbajtja në gatishmëri teknike të 27 hidrovoqeve. Këto punime mirëmbajtjeje synojnë ruajtjen e ritmit të punës ciklik vjetor për përmirësimin ujitjes në 25 mijë hektarë para sezonit të ujitjes, përmirësimin e ujitjes në rreth 45 mijë hektarë si dhe garantimin e kullimit me ngritje mekanike për 70 mijë hektarë.

Për sa i përket skemës së mbështetjes kombëtare të sektorit fondi i parashikuar është rreth 843 milionë lekë. Kjo do të jetë një skemë mbështetëse komplementare me programin IPARD 2, me synim shmangien e çdo mbivendosjeje. Ne, sigurisht, do të vazhdojmë me praktikën e nisur për aplikimin me zero dokumente për masat direkte për fermerët.

Për sa i përket IPARD-it, fondi i parashikuar për vitin 2020 është 540 milionë lekë financim i brendshëm dhe 1,5 miliardë lekë financim i huaj, përveç tri masave ekzistuese që kemi aplikuar në thirrjen e parë dhe të dytë dhe në vitin 2020 do të përfshihet edhe masa e katërt, ajo e asistencës teknike. Gjithashtu, do të vazhdojë disbursimi i fondeve që janë alokuar nga dy thirrjet e para.

Në zërin e shpenzimeve operative për veterinarinë dhe sigurinë ushqimore, kemi një zbritje me rreth 57 milionë lekë krahasuar me vitin 2019, por kemi një rritje me 204 milionë lekë shtesë për sa u takon investimeve të brendshme, krahasuar gjithmonë me vitin 2019 dhe 100 milionë lekë shtesë investime të huaja, krahasuar gjithmonë me vitin 2019.

Synimet kryesore të programit të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit për vitin 2020 lidhen kryesisht me reformën veterinare dhe forcimin e sigurisë ushqimore.

Me riorganizimin që do t'i bëjmë të gjithë strukturës së shërbimit veterinar gjatë vitit 2020, kemi planifikuar të rrisim afërsisht me 2,5 herë numrin e veterinerëve, duke ofruar shërbimin veterinar më afër fermerit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020 për shkak të fuzionit që do të bëhet me pjesën më të madhe të inspektoratit të shëndetësisë, rreth 15 mijë biznese do të kontrollohen nga një inspektorat, që deri më sot janë kontrolluar nga dy inspektorate për probleme pak a shumë të ngjashme dhe për të njëjtin kategori biznesi.

Së fundi, në lidhje me peshkimin në vitin 2020 do të bëhet i mundur investimi në merkaton e peshkut të Vlorës, me një buxhet rreth 190 milionë lekë.

Gjithashtu, do të hapet mundësia për kredinë italiane prej 25 milionë eurosh për rehabilitimin e tri porteve të peshkimi që kemi sot dhe për ndërtimin e disa moleve për peshkim të vogël artizanal në të gjithë Shqipërinë.

Do të vihet në funksion sistemi i bluboxit me një financim prej 165 milionë lekësh.

Ky ishte buxheti në mënyrë të përmbledhur i parashikuar për bujqësinë për vitin 2020. Për çdo pyetje apo koment jemi të hapur për komunikim.

Faleminderit edhe një herë për vëmendjen!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka relatori, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Faleminderit, zoti Ministër!

Në diskutimin që bëmë në prezantimin e përgjithshëm të buxhetit nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë unë u shpreha që në nivel të përgjithshëm projektbuxheti i paraqitur nga qeveria është prudent, por në rastin e buxhetit të Bujqësisë, pra e të gjithë sektorëve që lidhen me dikasterin që drejton zoti Çuçi, ky buxhet është ambicioz jo vetëm në shifrat që parashtrroi ministri në rritjen e fondeve disponibël në vitin 2019 krahasuar me vitin 2020, por edhe në përpjekjet që bën duke investuar drejtpërdrejt dhe duke bashkëfinancuar skemat mbështetëse, por edhe paratë që janë vënë në dispozicion, ndoshta jo në një vlerë të madhe, për të vënë në jetë mekanizma të rinj institucionalë që do të duhet të japin një shtysë edhe më të madhe zhvillimit të këtij sektori. Ky sektor, gjithnjë e tepër po del nga qëllimi që ka pasur për shumë vite, që ka qenë mbajtja e mbijetesës me prodhim për vetë konsum për familjet që jetojnë në fshat, por ka edhe me një vlerë të shtuar në ekonomi me kontribut shumë të mirë, kohët e fundit në mënyrë sistematike, me eksportet dhe për rrjedhojë në përmirësimin e bilancit tregtar, në përmirësimin e llogarisë koherente të shtetit dhe të ekonomisë, por edhe në zhvillimin e diçkaje, që unë nuk nguroj ta quaj, edhe pse mund të duket si një term shumë marksist, sovranitet ushqimor i vendit. Me këtë nuk dua të them që Shqipëria të prodhojë bukën në vend dhe çdo gjë, por mund të prodhojë një numër të kufizuar prodhimesh bujqësore e blegtorale, të cilat mund të mjaftojnë të krijojnë aq para sa të

importojmë dhe ushqimet e tjera. Pra, nëse sot kemi ardhur me një raport me rreth 3,2 me 1 import – eksport në ushqime, përpara 6 vjetësh e kemi filluar me 6,4 me 1, por ky raport do të duhet të jetë sa më i zbutur në vlerë që të synojë drejt balancimit, pse jo të dalë edhe pozitiv, në funksion të qëndrueshmërisë së sektorit.

Zoti kryetar, unë kam 2 – 3 momente, meqenëse është edhe prezenca e ministrit këtu, unë mendoj se ka ardhur momenti që të bëjmë një lloj rivlerësimi të politikave të marra ndër vite. Nëse thamë se qeveria nuk ka parashikuar politika të reja fiskale në të gjithë sektorët për të bërë një analizë më të mirë të asaj çfarë ka ndodhur, mendoj se edhe tek ujitja dhe kullimi ne duhet të ndalemi. Ministri e tha që ujitjen e kemi dyfishuar dhe kullimi shkon me 3 herë më shumë, por nuk mund të themi që, meqenëse vadisim 2 herë më shumë, kullojmë 2,5 herë më shumë, ne prodhojmë 2 herë më shumë. Nëse e marrim në nivel të përgjithshëm, përveç eksportit të kontributi i bujqësisë në GDP jemi pak a shumë në ato nivele dhe unë personalisht mendoj se hallka e dobët janë kanalet e ulëta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotit Çuçi do t'i kërkoj të revizionojë edhe reformën territoriale, kur e konceptoi përpara 5 vjetësh. Pra, a kemi qenë të drejtë përpara 5 vjetësh kur thamë se kanalet e treta do t'ua lëmë bashkive, sepse unë mendoj se këtu është kontradikta?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta lë fare, sepse nuk e kuptoj pse sa herë që flas unë bëhet rrëmuje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra çfarë do që të bëjmë ne me kanalet e larta dhe të mesme, po nuk shkuam te “ugarët”, kështu thuhet Berti, sepse e kam vjedhë këtë shprehje, ne e kemi lënë përgjysmë. Bashkitë tona a e kanë dëshirën, nevojën dhe kapacitetet për ta bërë këtë punë?

Përpara ca vitesh u dhamë të gjithëve nga një mjet të madh, nëse ai mjet u duhej për të rikuperuar mungesën 20-vjeçare, a u duhet në të gjithë vitin? A mos duhet t'i bashkojmë ato me disa mjete të tjera më të mëdha që të përdoren në mënyrë eficiente? Kjo do një analizë, sepse do të duhet të jemi më efektivë në çështjet e ujitjes. Praktikisht për 6 vjet ne kemi investuar rreth 180 milionë dollarë, ende nuk kemi dyfishuar prodhimin, por të paktën 30 – 40% duhet ta rrisim. Kjo është e para.

E dyta, ne vjet miratuam një ndryshim në skemën e rimbursimit të TVSH-së në bujqësi. Por në këtë vit, të paktën në kontaktet e mia, kjo skemë ka rezultuar shumë e pëlqyeshme nga eksportuesit dhe jo shumë e pëlqyeshme nga agro-përpunuesit.

Sot kush kultivon verë thotë që ka më leverdi ta marrë nga importi, sesa ta marrë nga fermeri. Disa njerëz shkojnë deri në ekstrem që ta marrin domaten nga Fieri ta eksportojnë në

Greqi dhe ta riimportojnë në Shqipëri, sepse futet më kollaj në qarkullim. Këtu duhet të kemi parasysh një gjë, ne që jemi këtu duhet të shikojmë më lart dhe më gjerë. Eksportuesi dhe agro-përpunuesi janë hallka të zinxhirit, pra dikush është mirë dhe dikush nuk është, por ata që janë mirë thonë që kemi bërë detyrën dhe nuk thonë faleminderit dhe kush është më keq qan. Kjo është një gjë që dihet dhe nuk presim të ndodhë ndryshe. Pra edhe kjo do një rivlerësim.

E treta, kam një detaj të vogël lidhur me peshkimin. Përpara ca vitesh me insistimin e binomit Shalsi – Baraj, kur është miratuar ligji i peshkimit është vënë një ngrirje e lejeve të reja deri sa të mbaronte një studim i të gjithë detit dhe të përcaktohej se kur do të lejohej kultivimi i peshkut me farming.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, vetëm me farming. Kjo hartë ende nuk është publike. Nuk po them se ka kaluar afati dyvjeçar, tani ti me Nikon do e ndani kush më shumë e kush më pak, por po them se ka njerëz që duan të investojnë dhe nuk është gati. Ne u detyruam të bëjmë një amendim për të shtyrë diçka dhe më kujtohet që kur ka ardhur këtu zëvendësministri që mbulon peshkimin për të bërë shtyrjen e afatit, pati thënë që këtë vit e mbarojmë dhe më duket se ishte një investim italian. Por me sa informacion që kam marrë unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kam mbaruar akoma. Ju në një takim publik përcollët një mesazh nga Brukseli, që edhe pse nuk na e hapi atë që duhej të hapte, na thanë që të pakësojmë flotën e peshkimit. Pra mirë që nuk na qasnin, por ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Na thonë pakësojeni, mos u rrisni më.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne vërtet që kemi arritur me kuotat e kocës, por këtë det për çfarë e kemi?

Zoti kryetar, përveç relatimit të përgjithshëm, unë këto tri momente kisha. Nuk po marr më shumë kohë që t'ua kaloj fjalën kolegëve për pyetje dhe diskutime.

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Beqja!

Fillimisht do të fillojmë me pyetje dhe pastaj do të kalojmë në diskutime.

Fjalën e ka zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, shkëlqesi Ministër! Unë kam tri pyetje për ju. E para, a keni parashikuar për digën që ndan Velipojën me fushën e Torovicës, e cila në këtë moment është e çarë në të gjithë aksin e tij, majtas kur shkon ose djathtas kush zbret nga Velipoja?

E dyta, çfarë masash do të merrni tani, sepse jemi në pragun e tregut të madh të mollëve në Korçë dhe fermerët, kur ishim në vizitën e fundit, thanë se qeveria nuk na subvencionon në momentin që ne kemi dëme, pra e kam fjalën për mollët e kalbura?

E treta, ky buxheti është për vitin që vjen dhe normalisht në treg do të dilet me domaten tonë që është shumë e mirë. Kjo domatja me hormone a mbahet nën kontroll nga ju, që kur të blejmë domate të mos kërkojmë vetëm italianet? Këto domate kur i çajmë dalin lloj-lloj rrënjësh dhe ne që kemi studiuar Universitetin Bujqësor të Tiranës e kemi problem.

Zoti kryetar i komisionit, përfitoj nga rasti t'ju them se Universiteti Bujqësor i Tiranës ka kërkuar nga komisioni ynë që të ketë një përfaqësi që të jemi atje. Kjo ishte për ju, ndërkohë që pyetjet ishin për shkëlqesi ministrin.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Fjalën e ka zoti Valteri.

Halit Valteri – Duke lexuar politikat sektoriale dhe për përfitimet për qytetarët, dua t'ju përgëzoj për nismat që keni marrë dhe shpresoj të mos ngelen në letër, por të realizohen të gjitha.

Zoti Çuçi, unë kam një problematikë, shpeshherë shikojmë raste kur fermerët nga mbarë Shqipëria, por kryesisht nga zona e Myzeqesë, dalin e hedhin produktet e tyre, sepse u janë kalbur, kjo si pasojë e mos gjetjes së shitjes. Pra politikat e firmave që bëjnë grumbullimet kanë 1001 vështirësi ose 1001 arsye që ata nuk gjejnë dakordësi mes tyre. Gjithashtu, kemi parë edhe shifra të larta të importit nga dogana. A mundet që qeveria t'u krijojë lehtësira fermerëve me subvencionime dhe t'ju rrijë si çekiç mbi kokë që ata të rrisin cilësinë dhe të nxjerrin një produkt të barabartë me atë që vjen nga jashtë, por me një çmim më të ulët dhe konkurrues në treg, ku kostot të mbulohen pak nga shteti dhe pak nga ata që shpërndajnë? Unë shikoj që shpërndahen me mijëra euro për subvencione dhe na lind e drejta të themi që ka pasur dallime, pra që njëri është i njerkës dhe tjetri i nënës. Pra, a mundet qeveria shqiptare t'i kontrollojë importet që hyjnë dhe prodhimin vendas?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Zoti Ministër, faleminderit për parashtrimin që i bëtë situatës së viteve 2018-2019, por edhe parashtrimin për buxhetin e vitit 2020. Ne jemi komisioni përgjegjës për veprimtarinë tuaj dhe duhet të japim ndihmën tonë për atë që ju kërkonin të bëni vitin që vjen, por me shifrat që shikoj besoj se ndihma makro jona është pothuajse e realizuar, sepse keni një rritje të buxhetit, të cilën do ta diskutojmë. Por unë dua të futem më në detaje të kësaj ndihme që mund të japim.

Vitin e shkuar ne kemi bërë një paketë fiskale, e cila ka pasur të bëjë me uljen e tatimit të fitimit në lidhje me makineritë bujqësore dhe me TVSH-në e farave e pesticideve. Në relacionin e buxhetit po lexoj: “Synojmë për vitin që vjen rritjen e numrit të të punësuarve në bujqësi dhe agropërpunim”. Në fakt, pyetja ime ka të bëjë me këtë gjë, ne duhet të synojmë rritjen e efikasitetit të përdorimit, pra të rrisim rendimentin e prodhimit për metrat katrorë të tokës bujqësore që kemi, sepse sot sipërfaqet e tokave të papunuara pothuajse janë minimale, ndoshta do të ketë akoma diçka, por janë minimale. Pra, ne në përgjithësi e punojmë tokën, kemi rritje shumë të madhe të prodhimit bujqësor dhe ndikimi në GDP-i është i rëndësishëm. Ju e thatë që kemi vajtur 1 me 3, por më kujtohet se kemi qenë 1 me 6, pra përmirësimet i kemi të mëdha. Por, ajo që duhet të mendojmë për të ardhmen, sepse tokën po e punojmë, është si të rrisim rendimentin e kësaj gjëje, pra politikat tona në raport me makineritë dhe pajisjet a kanë dhënë atë rezultat që prisnim? A kemi ende ndonjë gjë për të bërë? Duke pasur parasysh edhe faktin që ne kemi tentuar të japin incentivat edhe për bashkimin e fermerëve në ferma më të mëdha, pikërisht për këtë efekt, për të rritur rendimentin në prodhim, cili është mendimi juaj, si e gjykoni ju, a janë të mjaftueshme këto iniciativa që kemi marrë, apo kërkoni mbështetjen tonë për diçka tjetër? Rritja e rendimentit është ajo që duhet të bëjmë në të ardhmen, në aspektin e prodhimeve bujqësore.

Ju e theksuat, i dhatë edhe me shifra se sa është përdorimi i fondeve, qoftë të IPARD-it, qoftë të buxhetit të shtetit në raport me mbështetjen për bujqësinë. Ju dëgjova me vëmendje edhe për diçka që ka të bëjë me asistencën teknike, e cila do t’u ofrohet fermerëve. Si e gjykoni, përdorimi i këtyre fondeve ka qenë i mirë, i mjaftueshëm apo ka vend për përmirësime? Çfarë ndihme më konkrete mund të japin ne në raport me ju, që çdo fond të përdoret sa më shumë?

Niko Peleshi – Po, zoti Baraj

Besnik Baraj - Faleminderit!

Pa dyshim që sektori juaj përballlet me shumë sfida. Ndërmjet të tjerave edhe në procesin aktual një nga sfidat është absorbimi i burimeve financiare që vijnë nga BE-ja, që lidhen me cilësinë e projekteve, të aplikuesve të ndryshëm fermerë. A mendoni se kapacitetet tuaja në sektorin që merret me projektet janë të mjaftueshme për të integruar të gjithë këtë fushë, për të kontrolluar, për ta bërë atë të përshtatshme që të fitojë në aplikimin që do të bëjë? Kam dëgjuar se ka edhe njësi private, por përgjegjësia në finale i përket ministrisë suaj. Në atë mënyrë, siç ekzistojnë në vendet e tjera në sektorin tuaj ka burime njerëzore të mëdha dhe shumë cilësore që merren me menaxhimin e aplikimit të projekteve për të

mundësuar fitimin e tyre. A keni parashikuar në buxhet që të forcoheni me burime njerëzore dhe me ato që mund t'ju duhen si: logjistikë, trajnime për të përballuar këtë lloj sfide?

Niko Peleshi - Po, zoti Jakimi.

Halil Jakimi - Zoti Ministër, kam dy pyetje. Nuk është qartësuar dhe saktësuar pjesa e subvencionimeve të plehrave kimike dhe të akcizës së naftës bujqësore. Çfarë përfshin buxheti i vitit 2020?

Në lidhje me ndërtimin e tregjeve për grumbullimin e prodhimeve bujqësore. Unë flas për qarkun e Dibrës, ku jam deputet. Po marrim edhe pemëtarinë, më të kultivuara janë mollët dhe qershitë në masën më të madhe, por edhe ato gjejnë vështirësi të mëdha dhe fermerët pothuajse e kanë të pamundur t'i tregtojnë prodhimet e tyre bujqësore. Shikoj se është e përqendruar te privati pjesa e mbledhjes dhe e shitjes së tyre. Fermerëve nuk u vihet në ndihmë nga administrata për lidhjet që mund të bëjnë me eksportuesit ose me grumbulluesit e mëdhenj që t'u krijojnë një farë kontakti. Sa herë shikoj se zyrat e bujqësisë nëpër rajone nuk e bëjnë një gjë të tillë, edhe bashkia nuk ka një treg, një vend përkatës, pasi ai e ka prodhimin, por nuk e tregton dot ose ta çojë në filan pikë dhe ta shesë dhe jo të prishen, për shembull qershitë, meqenëse ka ciklin, një periudhë shumë të shkurtër. A parashikohet buxhet për ndërtimin e tregut apo të një pike grumbullimi, të paktën në zonën ku ka bujqësi të zhvilluar? Si zgjidhet kjo gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi - Je gabim, sepse ka mollë industriale ka dhe mollë për tavolinë. Nëse ai i lëngut të mollës nuk ka mollë industriale kjo nuk ka lidhje me diskutimin e zotit Jakimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ke të drejtë, por tjetër gjë është industria.

Po, fjalën e ka zoti Bitri që ka folur më pak nga të gjithë sot.

Robert Bitri – Zoti Ministër, masa që morëm për uljen e TVSH-së, sa ishte efektive? Për të gjitha për imputet, farërat, TVSH-në mekanike e të gjitha me radhë.

A mos ka ardhur koha të fillojmë të mendojmë se ku duhet të vihet TVSH-ja për eksportin: pikave të grumbullimit apo fshatarit? Duhet të gjejmë një mekanizëm, sepse pikat e grumbullimit nuk ia japin fshatarit dhe një pjesë të madhe të saj e mbajnë për vete. Duhet ndonjë masë, si e keni parë këtë gjë?

Edukimi i mentalitetit të kooperimit ose me subvencione, ose me forma të tjera shtrënguese financiare ose ndihmuese financiare. Të mendojmë për kooperimin, pasi është e vetmja formë, e cila është domosdoshmëri për fazën ku jemi sot në Shqipëri.

Mund të them edhe diçka për pjesën e domateve dhe të prodhimeve që mbeten stok.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duke lënë mënjane modestinë, e njoh më mirë nga të gjithë këtu.

Sivjet ngaqë koha ishte shumë e mirë prodhimi i fushës vazhdoi më gjatë dhe prodhimi i serrave erdhi herët. Nuk kemi pse të pretendojmë që të ndërhyjë qeveria, por nga momenti që nuk kemi kontrata ndërmjet atij që grumbullon dhe atij që prodhon, automatikisht do të gjendemi para një faze të tillë që detyrimisht kur prodhimi është me shumicë, duhet të gjendet treg për t'i shitur. Këtë detyrë e kanë pikat e grumbullimit, por fermeri duhet të jetë cilësisht shumë i saktë në atë që eksportojmë. Flas duke e njohur zonën e Fierit, disa që kishin lidhur kontrata me Italinë për shkak të herbicidit që erdhi për ngjyrim, iu kthyen 3 ngarkesa dhe në atë moment ai e prishi të gjithë kontratën, sepse edhe ne nuk kemi kontrata me detyrime ligjore, se nuk duam të mbajmë përgjegjësi: as fshatari, as grumbulluesi dhe as të huajt, të cilët atë duan që në çdo moment kur kanë super prodhim të mos e marrin tek ti, ose të ulin çmimin për njësi. Në këtë pikë, ne si shtet nuk kemi pse të pretendojmë të hyjmë, sepse kjo është një marrëdhënie individuale private, por mekanizmat e sistemit të vjetër, duke ngritur firma të cilat mund të jenë shtete, sidomos vetë bashkitë, pasi bashkitë me të vërtetë duan të gjithë kohën të përfitojnë subvencione, por asnjëherë nuk marrin përsipër të sigurojnë pika grumbullimi. Për shembull, për punën e farave le të kemi monopole, farërat, herbicidet, pesticidet le të jenë monopole, por nëpërmjet monopolit jo për të përfituar ai që ka monopolin, por për të fituar shteti, sepse nëpërmjet monopolit kontrollojmë dhe çmimet edhe cilësinë. Kështu e gjykoj unë.

Niko Peleshi – Po, zoti Konomi.

Ardit Konomi – Po i referohem modelit të Korçës për të evidentuar një problematikë, por edhe për të parë nëse ka diçka të menduar në lidhje me të. Në Korçë numërohen 4500 hektarë mollë, kryesisht një sasi, e cila nuk është e vogël edhe për vende të mëdha eksportuese të BE-së sot, ndërkohë që mekanizmi bazë i marrjes së të dhënave, formalizimit që kemi sot është autofatura te fermeri. Ne sot jemi në gjendje të ruajmë afërsisht me grumbulluesit frigoriferikë 20% të këtij prodhimi. Pjesa tjetër shitet nën dorë në tregje të paformalizuara apo arrin ciklin e prishjes së produkteve dhe shkon si nënprodukt për industrinë agropërpunuese. Bazuar te kjo, së fundi kemi pasur një takim me një grup fermerësh, specialistësh të bujqësisë atje dhe kam dëgjuar kërkesën e përsëritur për të parë alternativat për të subvencionuar prodhimin, si një mekanizëm i cili do të jepte edhe garancitë e formalizimit të tregut, por nga ana tjetër një pikëpyetje që është ngritur pas saj kanë qenë kostot që shoqërohen në buxhetin e shtetit.

Dua të di nëse ka pasur ndonjëherë ndonjë llogari apo është në fokusin tuaj një përlllogaritje e balancës së re që mund të vendoset në këtë rast, pra subvencionimi përkundrejt të gjitha benefiteve financiare që ka buxheti i shtetit për shkak të formalizimit, duke parë sa është numri i fermerëve që përfitojnë sot nga subvencionimi?

Niko Peleshi - Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Po, zoti Ministër!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Do të mundohem që të jem shterues, por gjithsesi përgjigjet e mia mund të plotësohen edhe nga stafi, specialistët dhe ekspertët që më shoqërojnë.

Po e filloj me pyetjet e relatorit, të zotit Beqaj. Për pjesën e një rishikimi të strategjisë për sa u përket investimeve që po bëjmë në kanalet ujitëse, mendoj se kemi ende nevojë, por nuk është vetëm ujitja, por edhe kullimi që është një element shumë i rëndësishëm. Kemi ende nevojë që të asistojmë fermerin për sa i përket shtrimit të rrugëve, të dërgimit të ujit në parcelë.

Ju thatë dhe bëtë një kritikë në lidhje me mënyrën sesi është ndarë përgjegjësia për pastrimin e kanaleve të niveleve të ndryshme, duke e lidhur këtë me një pyetje, sesa kemi arritur ta çojmë ujin në parcelë. Ju thatë se duke lënë kanalet, (kam një korrigjim të vogël) kanalet e treta i ka vetë fermeri, kanalet e dyta u kanë kaluar bashkive, pra autostrada kryesore mbetet gjithmonë në administrim, nën përgjegjësinë e ministrisë. Kanalet e dyta mbeten në administrimin, në përgjegjësinë dhe pronësinë e bashkive, ndërsa kanalet e treta janë brenda parcelës dhe çojnë ujin direkt te parcela. Për kanalet e treta përgjegjësia është e vetë fermerit për t'i mirëmbajtur. Për kanalet e dyta janë bashkitë. A kemi bërë mirë që ua kemi kaluar bashkive apo jo? Unë vazhdoj t'i qëndroj mendimit që kam pasur se kjo është gjëja më e mirë që kemi bërë, për arsye se askush më mirë sesa kryetari i bashkisë, nuk mund ta ketë vëmendjen të funksionimi i këtyre rrugëve. Ai përballet drejtpërdrejt me komunitetin, me njerëzit. Nuk mund të jetë kurrë i vëmendshëm, sado i përkushtuar të jetë një ministër i Bujqësisë për nivelin e kanaleve të dyta, sesa kryetari i bashkisë. Kur ne ia kemi kaluar, sigurisht që kaluam edhe një fond, të paktën një mesatare që shpenzonim ne, midis fondeve për mirëmbajtjen e kanaleve të dyta dhe të para, për ato kanale të dyta ia dhamë bashkive. Por duke decentralizuar, i dhamë edhe mundësinë kryetarit të bashkisë që me fonde të tjera, me politikat që do të bënte brenda bashkisë të investonte në pastrimin dhe në krijimin e arterieve që do të lidhnin kanalet e para me parcelën. A e kanë bërë këtë gjë kryetarët e bashkisë? Kemi raste shumë të mira, sikundër kemi edhe raste që nuk ka funksionuar. I qëndroj fort kësaj që them, por kjo nuk lidhet me skemën që kemi adaptuar.

Unë i besoj shumë decentralizimit në këtë pikë. Kjo lidhet me mënyrën e performancës së kryetarit të bashkisë. Është një raport i vështirë që do kohën e vet të vendoset, por është vetmja rrugë që do të na çojë në një qëndrueshmëri të këtij aspekti të sektorit në investime.

Rasti i Fierit është për mendimin tim rast për t'u marrë model, absolutisht një rast që duhet të përshëndetet, sepse kryetari i Bashkisë së Fierit ka dedikuar jo vetëm fonde që i japim ne nga buxheti i shtetit drejtpërdrejt për kanalet, por ka bërë një strategji shumë të qartë duke angazhuar dhe duke mobilizuar edhe fonde që ai i ka nga të ardhurat e tij në funksion të kësaj, dhe sot Fierin e kemi në një situatë shumë të mirë, për sa i përket kësaj gjëje.

Rasti i keq, ndoshta mund të them Vlora apo Shkodra, për shembull, që nuk e kanë vëmendjen të kjo gjë, por ky është një problem që e rregullon mekanizmi i modelit politik që ne kemi zgjedhur, sepse sado i përgjegjshëm, sado i fokusuar të jetë një ministër Bujqësie, kurrë nuk do ta ketë vëmendjen siç mund ta ketë kryetari i bashkisë.

Përveç kësaj, kryetarët e bashkive mund të mobilizojnë fonde të tjera, i vendosin vetë prioritetet.

Për sa i përket disa të dhënave që ju kërkuat për problemet se a kemi ujitur më shumë tokë apo jo, theksoj se prodhimi bujqësor është çdo vit në rritje. Po të marrin edhe statistikën tjetër, që ndoshta nuk është e drejtpërdrejtë, por në një masë të madhe e tregon rritjen e prodhimit bujqësor, është eksporti në bujqësi, i cili ka dhënë efektin e vet.

Me Bankën Botërore ne po zhvillojmë një metodologji për të matur impaktin që kanë investimet në kanalizime në sistemin e ujitjes dhe kullimit, në mënyrë që të kemi një metodë gati shkencore dhe për të arritur në konkluzione nëse do të na duhet që në një moment x ne ndoshta mund të ndërpresim vëmendjen e shtuar për këtë gjë dhe mund të fokusohemi në një gjë tjetër.

Për sa i përket vitit 2020 ne vazhdojmë të jemi në këtë trend dhe gjykojmë se duhet të vazhdojmë të mbetemi në këtë trend, sepse ka rëndësi edhe metodologjia. Ne nuk kemi një metodologji se si ta masim impaktin, se si ta masim kënaqësinë e përfituesit për sa i përket, sidomos, sistemit të ujitjes, se kullimin e kemi shumë më kollaj për ta matur.

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Beqaj!

Ilir Beqaj – Eksporti është rritur edhe në volum, edhe në vlerë dhe kjo gjë është matja më e saktë, se eksporti matet në doganë.

Sipas INSTAT-it prodhimi i përgjithshëm nuk është rritur. Kemi perimet, kemi drurët frutorë që janë rritur, por prodhimi i përgjithshëm bujqësor ...

(Diskutime pa mikrofon)

... Nuk po flas për vlerën e bujqësisë në GDP, po e lë mënjanë, por po flas për INSAT-in që raporton sasi dhe sasitë e përgjithshme nuk rezultojnë të rritura. Ndërkohë, ka një dukuri. Po të shohim inflacionin sipas INSAT-it, ka një dy vjet që perimet dhe frutat janë shtrenjtuar shumë. Kjo do të thotë se kemi qenë të zotë për të dalë në eksport në kurriz të ofertës vendase që mund të jetë përkthyer në shtrenjtësi për shqiptarët. Është deduksion indirekt, por INSAT-i thotë se po t'i matësh me volum, jo me vlerë, edhe perime, edhe në serrë, edhe në dru frutorë, edhe në bimë arash volumet në vite rriten 0,5 apo 1%. Ne kemi dyfishuar sipërfaqen nën ujë, kemi 2,5 herë më shumë kullim. S'mund të japë dyfishi i investimeve në ujitje vetëm 3%.

Ju vërtet i qëndroni modelit dhe thoni se e keni bërë mirë, është shpejt për të thënë se nuk kemi bërë mirë. A duhet t'ia lëmë përgjegjësisë politike dhe përgjegjësisë së bashkisë, që matet vetëm një herë në 4 vjet, këtë gjë që është shumë e rëndësishme për ne? Kjo duhet diskutuar, por nuk është teme për tryezën e sotme.

Niko Peleshi – Urdhëroni!

Bledi Çuçi - Faleminderit!

Unë mendoj që në vlerësimin e impaktit të ujitjes dhe kullimit, si dhe lidhen e tij të drejtpërdrejtë vetëm me prodhimin...

(Diskutime pa mikrofon)

E para, duhet parë në terma më afatmesëm dhe jo drejtpërdrejt...

(Diskutime pa mikrofon)

E dyta, kemi një ndryshim të strukturës së të mbjellave.

Kjo gjë po ndodh në favor të kulturave që kërkojnë domosdoshmërisht ujë dhe nuk po flas vetëm për perimet, por edhe për pemëtarinë në përgjithësi, edhe për ullirin, (nga tradicional që mbillej në sipërfaqe nën ujë, kemi një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqeve të mbjella 3-4 vjetët e fundit që është nën ujë). Kam parasysh edhe kohën e hyrjes në prodhim dhe mund të them se kemi rritje të numrit të rrënjëve, faktikisht, në pemëtari dhe vreshtari, që ende nuk reflektohet në terma prodhimi sepse ka ciklin e vet.

Faktori tjetër është se pa ujitje në brezin tonë klimatik jo vetëm që nuk mund të pretendojmë rritje të prodhimit, por duhet të jemi shumë vulnerabël ndaj ndryshimeve të forta sezonale. Po të shikojmë statistikën, trendi ynë në dallim nga rajoni është i qëndrueshëm dhe ne që merremi drejtpërdrejt me atë punë kemi pasur hezitime në pasaktësi eventuale të statistikave.

Në fakt, stabilizimi i prodhimit dhe trendi i rritjes identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj këtij faktori.

E treta, prodhimi bujqësor është një shumatore faktorësh. Pra, mund të optimizosh një faktor, por nëse faktorë të tjerë nuk janë optimalë, nuk mund të marrësh maksimumin e këtij faktori. Pra, unë do të thosha që duhet ta shohim në këtë këndvështrim. Edhe ekspertët nga vendet e rajonit, që kanë përvojë, e vlerësojnë shumë pozitive qasjen tonë.

Natyrisht, është ajo që tha zoti ministër, që ne ende kemi nevojë të zvogëlojmë shifrën e sipërfaqes së rehabilituar me sasinë e duhur të ujit dhe kjo kërkon detyruesisht rritje të kapaciteteve të bashkive, pra, nuk kemi të njëjtin nivel të performancave të bashkive.

E fundit, fermeri duhet të jetë i vetëdijshëm që ky është një shërbim publik që i ofrohet, por nuk e zëvendëson në asnjë rast fermerin në vetvete.

Format që ne po gjejmë, mekanizmat që kemi futur, po kërkojmë edhe nga bashkitë imponimin e kostos së mirëmbajtjes, pavarësisht nëse e paguan në para apo në shërbim, që ta bëjmë sistemin e qëndrueshëm.

Edhe eksperiencia e rajonit apo më gjerë nuk sugjeron qasje tjetër. Sivjet ne kemi pasur një vit ekstrem në të dy parametrat.

Deri në fund të qershorit nuk kemi vaditur asnjë metër katror tokë, sepse rreshjet ishin të tilla, pastaj kaluam në ekstremin tjetër. Por pa pasur investime publike dhe pa pasur garancinë se sistemi do ta furnizojë, mund të merrnim një goditje shumë me ekstreme se sa e kemi.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

Kujtim Gjuzi - Faleminderit!

Me logjikën që përdorët ju, i nderuar, i bie që zoti Beqaj, i cili këmbëngul te pjesa që i delegohet pushtetit vendor, të rishikohet dhe ne prandaj jemi këtu.

Edhe ju, në një farë mënyre, suportuat atë që tha zoti Beqaj, pra është bërë gabim që është deleguar atje se bashkitë nuk kanë ardhur te niveli.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, i bie që unë tani që dëgjoj specialistin dhe deputetin, të jem në krahun e zotit Beqaj për këtë problem.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk di pse u futëm në këtë ngërç.

(Diskutime pa mikrofon)

Faleminderit!

Niko Peleshi – Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, urdhëroni zoti Ministër!

Blendi Çuçi – Në lidhje me avantazhin që krijojmë midis eksportuesve dhe agropërpunuesve mendoj se do të vazhdojmë me të njëjtën skemë në vitin 2020.

Për sa i përket peshkimit, te pjesa e akuakulturës, studimi është me financimin e BE-së dhe është një kompani italiane që po e bën. Kjo është brenda zbatimit të kontratës, sepse është me shumë rëndësi që ne të përcaktojmë shumë qartë vendet ku duhen bërë fermat e peshkut. Për hir të së vërtetës, deri para pak kohësh janë dhënë pa e parë të gjithë bregun e Shqipërisë si një të tërë, sidomos për aspektin që lidhet me mbrojtjen e brigjeve dhe mbrojtjen në ambientit.

Pa mbaruar ky studim dhe pa marrë raportin përfundimtar ne nuk mund të fillojmë të japim të reja. Në vitin 2020 mbaron kjo kontratë.

Tani po i drejtohem zotit Gjuzi. Për hir të së vërtetës, nuk e identifikova dot digën e Velipojës...

(Diskutime pa mikrofon)

Do ta verifikojmë, zoti deputet.

Për mollët në Korçë, meqenëse kishte një shqetësim, po theksoj se, pa diskutim...

(Diskutime pa mikrofon)

Te çështja e mollëve ka disa aspekte që duhen diskutuar.

Aspekti i parë lidhet me planifikimin dhe me kultivarin, për nga duhet të orientohet fermeri për të mbjellë.

E përmendi pak zoti Beqaj, mollën “Starkinge”, por s’ka rëndësi se kultivarë, të cilët deri para disa vitesh kanë qenë trajtuar si kultivarë tradicionalë dhe fermerët kanë qenë mësuar me mbjelljen e tyre, tani për planifikimin në fermë fermerët duhet të orientohen drejt kultivarëve që ecin, sidomos në eksport.

Vjet kishim një fenomen që ilustron shumë qartë këtë çfarë po them. Vjet molla “Fuxhi”, që vinte nga Italia, shitej me shumicë me 900 lekë në treg dhe sa vinte ishte e shitur direkt, ndërkohë që molla “Starkinge” e ardhur nga Korça ishte me 400 lekë dhe nuk shitej. Kjo tregon se fermeri duhet të ketë një oronim shumë më të mirë drejt varieteteve që duhet të mbjellin.

Për sa i përket pjesës së Ministrisë së Bujqësisë janë strukturat e këshillimit, të cilat duhet të punojnë shumë më ngushtë, jo vetëm me fermerët, por edhe me atë pjesë të sektorit në hallka të rëndësishme, siç janë shitësit, importuesit, kultivuesit e fidanëve dhe të imputeve bujqësore në përgjithësi dhe pikat e grumbullimit, të cilët duhet të kenë një panoramë të përafërt, (se asnjëherë nuk mund të parashikosh çka do të ndodhë gjatë vitit, sepse ndikojnë

edhe faktorë të tjerë, koniunktura e tregut, e kohës, e klimës e kështu me radhë), por duhet të jenë të orientuar drejt.

Për shembull, dihet se molla “Pinkledi” është mbretëresha e mollës në botë dhe shitet sa shkon në treg. Në Korçë kanë filluar ta mbjellin masivisht, në Dibër e kanë mbjellë dhe ka shumë sukses, pra molla “Pinkledi” po mbillet gjithnjë e më shumë dhe këtë ua solla si shembullin më të mirë, por kemi edhe kultivarë të tjerë, si molla “Fuxhi” që ka disa vjet që në Europë po preferohet shumë dhe që eksporti e kërkon shumë.

Së pari, është orientimi në fermë.

Së dyti, janë investimet në kapacitetet frigoriferike, kur bëhet fjalë për mollët.

Ju thatë se vetëm 20% në Korçë, ne kemi kapacitete, por edhe ai nuk është i plotë, sepse mbi pesëdhjetë frigoriferë që janë në gjithë qarkun, në dijeninë time, nga informacionet që kam unë si ministër, vetëm tre janë me ruajtje deri në pesëmujore, ndërkohë që duhej të kishte shumë më tepër.

Në këtë aspekt, duhet të orientojmë investimet që bëhen pikërisht për rritjen e kapaciteteve frigoriferike, por edhe të frigoriferëve modernë, të cilët tashmë shkojnë deri në dy vjet të ruajtjes së produkteve. Si e bëjmë ne këtë? Sigurisht, e bëjmë duke nxitur 60 % të financimit për frigoriferët në pikat e grumbullimit, nëpërmjet skemës së IPARD-it. Ka ndodhur para dy vjetësh, por edhe vjet, që bullgari vinte këtu, blinte mollën e Korçës kur ishte çmimi më i lirë, gjatë kohës kur kishte superprodhim e mbante në frigorifer në Bullgari, pastaj vinte e shiste po në Shqipëri të njëjtën mollë, në kohën kur çmimi ishte më i lartë.

Sigurisht, nëpërmjet strukturave tona, ne kemi bërë thirrje që të vijnë, të aplikojnë dhe të marrin deri në 60 % subvencion mbështetje për të investuar në këtë gjë. Kjo ishte e dyta.

E treta është konjunkturat e tregut dhe e motit, të cilat janë gjëra që nuk mund t'i kontrollojmë dot.

Sivjet kemi kushte të mira për sa i përket mollës, sepse ka pasur dëmtim të produktit në rajon, dhe deri më tani molla po ecën shumë mirë. Shpresojmë të vazhdojë të ecë po aq mirë sa ç'ka filluar.

Është edhe një gjë tjetër: po nxisim investimin e rrjetave në fermat e mollëve. Për shembull, me investimi që ka bërë Ylberi, nëpërmjet mbështetjes sonë, ka marrë financim dhe ka vënë sipër, për mbrojtjen nga breshëri, masë kjo që është shumë e rëndësishme për mollën. Pra, jemi duke nxitur pikërisht këto investime, që do të japin avantazhe të jashtëzakonshme.

Këtë kohë në rajon ka pasur prodhim të ulët të mollëve, kjo për shkak edhe të prishjes së prodhimit nga breshëri që ra kryesisht në pranverë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne jemi mirë ama. Me gjithë problemin që patëm edhe ne me breshërin, prapë do të kemi më shumë se vjet, sa i përket sasisë. Këtë e kam nga çfarë thanë vetë fermerët, kur ishim në Korçë.

Kësisoj, besoj se ezauruan pak edhe pyetjen tuaj, meqenëse edhe zoti Gjuzi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është tjetër gjë pastaj. Edhe në lidhje me atë kemi një politikë, dhe politika është të rrisim cilësinë nëpërmjet certifikimit në Global Gap. Në lidhje me këtë gjë, pa diskutim që kemi vëmendjen të posaçme, sepse certifikimi i Global Gap do të vijë nga pikat e grumbullimi, nga pikat serioze të grumbullimit, sepse janë ato që marrin certifikatat. Duke i mbështetur nëpërmjet shumë formave pikat e grumbullimit, ne do të rrisim sasinë dhe cilësinë e bashkëpunimit të pikave të grumbullimit me fermerët, duke nxitur bërjen e kontratave. Meqë jemi këtu, po i prekim të gjitha, e pastaj, nëse ngel ndonjë gjë, e themi në fund. Pra, duke nxitur lidhjen e kontratave. Ama, në kontratën që pika e grumbullimit do të lidhë me fermerin nuk parashikohet vetëm blerja e produkteve nga fermeri, por do të ketë edhe imponim nga pika e grumbullimit në lidhje me kultivarin që ai do të mbjellë, mënyra si do ta mbjellë, plehrat që duhet të përdorë, si dhe kohën kur do t'i përdorë.

Këto janë shumë të rëndësishme për të garantuar një prodhim sipas kërkesave që ka tregu jashtë. Sepse, besoj se për një gjë biem të gjithë dakord: që Shqipëria është shumë e vogël për të krijuar avantazh në sektorin e bujqësisë vetëm nëpërmjet konsumit të brendshëm. Po nuk gjetëm tregje të reja, ne nuk mund të kemi një sektor që mund të mbijetojë dhe të rritet. Prandaj i kemi dhënë shumë mbështetje pikave të grumbullimit. Po ju them: zbritja nga 20 % në 6 % e TVSH-së së rimbursueshme të produkteve bujqësore, që bëmë, ka ndikuar për mirë në këtë aspekt, sepse i ka hequr nga tregu pikat spekulante të grumbullimit, duke i dhënë më shumë përparësi atyre që mund të quhen serioze.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa diskutim që kontrolli do të rritet, por ne i shohim si partnerë në rritje, për këto shkaqe dhe arsye që sapo ju përmenda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, imponim nuk është fjala e duhur, sepse ministri nuk mund të nxjerrë një udhëzim, përmes të cilit të thuhet se kjo është kontrata tip. Absolutisht jo. kemi takime mes fermerëve, tregtarëve të imputeve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk bëjmë dot imponimin e kontratës, sepse janë marrëdhënie civile, të

cilat i rregullon Kodi Civil, nuk i rregullon dot institucioni publik. Pra, kemi takime midis fermerëve, tregtarëve të imputeve dhe pikave të grumbullimit. Këto janë momente shumë të rëndësishme, të cilat duhet të shpreshtohen. Unë si ministër, mund t'i jap urdhër shërbimit tim të këshillimit, që ta mbajë sa më ngushtë këtë lidhje. Sigurisht, kjo është një gjë që do të rregullohet dhe nëpërmjet tregut. Nuk është rrugë e lehtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse, kur s'e kanë mbajtur për vete? Gjithmonë e kanë mbajtur për vete.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, për pjesën e imputeve, thoni ju? Ishte edhe një pyetje këtu: sa ka ndikuar heqja e TVSH-së? Kemi rasteve të ndryshme. Domethënë, në disa raste ka pasur impakt të plotë, në disa raste ka pasur gjysmë impakti, në disa raste nuk ka pasur impakt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, që ta mbaroj! Edhe përpara miratimit të buxhetit i kam planifikuar një takim me të gjithë tregtarët e imputeve, tregtarët e shumicës, për t'u bërë edhe një herë thirrje, në mënyrë që të kontrollojmë pjesën e impaktit që ka pasur ulja e TVSH-së. E thashë: ka raste kur ka pasur impakt të plotë. Deri tashti, konkluzioni, i cili pak a shumë është i përbashkët tek të gjithë aktorët në këtë sektor, është se ajo që na çalon dhe ku ndodh spekulimi, është pjesa e farmacive bujqësore në përgjithësi, domethënë, hallka ndërmjet fermerit dhe pikës së shumicës.

Prandaj, nxitja e bashkëpunimit, e kooperacionit, që përmendët ju, ka shumë rëndësi. Në Shqipëri ka disa raste të kooperativave, të bashkëpunimit të fermerëve, sepse, përveç lehtësimeve që ndodhin për shkak të paketës fiskale që kemi bërë me TVSH-në e me tatimin e fitimit, u krijojmë mundësinë që të ketë marrëdhënie të drejtpërdrejtë me shumicën, për sa u përket imputeve bujqësore. Ky është një avantazh shumë i madh për ata që investojnë në fermë. Në lidhje me këtë, pashë një rast shumë të mirë në Libofshë të Fierit, te fermerët që kultivojnë në serrë rrushin e tavolinës. Ata ishin bashkuar të gjithë, dhe nuk kishin fare nevojë për farmacitë, pasi kishin lidhur kontrata me shumicat e imputeve bujqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'janë tamam serra, por serra quhen, s'ka rëndësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ua, të mbaroj me zotin Gjuzi.

Pyetja e tretë ishte në lidhje me domaten me hormone. Pa diskutim që në treg ka edhe abuzues. Ne kemi shtuar kontrollin, por ju garantoj se 90 % e prodhimit bujqësor shqiptar nuk ka asnjë nga këto probleme që unë ju përmenda.

Në lidhje me trajtimet shkencore sa i takon mënyrës së rritjes, shartimeve të ndryshme të produkteve, për t'i dhënë elementë shtesë produktit e kështu me radhë, pa diskutim që këto janë të gjitha të kontrolluara. Specat mëdhenj sa një shalqi mund të shohim në të gjithë tregjet e Europës, në Amerikë, në Gjermani, në Francë, në Itali e ku të doni. Kjo nuk do të thotë se janë me hormone dhe janë të dëmshme, por sot bota nuk mund të ushqehet, me këtë dyfishim a trefishim të popullsisë që ka, po nuk aplikojmë edhe këto mënyra në rritjen e shpejtë të produkteve bujqësore. Pra, kjo është një gjë e kontrolluar. Sa i takon këtij dhjetë përqindëshi që është, dhe pa diskutim që është, ne po marrim masa. Kohët e fundit, unë kam ndëshkuar një grup fermerësh të serrave të domateve e të specave. Indiciet i morëm në momentin kur ata donin të shkonin në eksport me prodhimet e tyre, por nga analizat doli se i kishin me mbetje të lartë të metaleve.

Ky proces është në dinamikë. Nuk mund të pretendojmë asnjëherë se mund ta bëjmë zero, sepse abuzues ka gjithmonë, por vëmendjen e kemi absolutisht mbi këtë çështje. Unë ju bëj thirrje, që të gjithë ne të kontribuojmë në promovimin e prodhimeve *Made in Albania*. Kjo është shumë e rëndësishme.

Niko Peleshi – Fjalën e ka zoti Gjuzi, më pas zoti Bitri.

Kujtim Gjuzi – Shkëlqesi Ministër, jam i qartë në lidhje me përgjigjet e pyetjeve të mia, por nëse më lejoni, një këshillë. Në bashkëveprim me Ministrinë e Shëndetësisë, e po ashtu edhe me ministren tjetër që kontrollon doganat, në rastin kur ata hileqarët e marrkan atje mallin tonë, na i bëkan një xhiro dhe na sillkan prapë po atë mall, ne e kemi të drejtën t'ua vëmë traun te dogana, apo jo? E vetmja këshillë. Ju falënderoj shumë për faktin e ishit kaq ekselent në përgjigjet që dhatë.

Faleminderit!

Zoti Bitri. Më pas zoti Beqaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo?

Në rregull! Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Unë kam të dhënat e nëntëmujorit, nuk i kam të dhjetëmujorit. Në 2018-ën, në peshë kilogramë, inputet janë 99 mijë e gjashtëqind ton. Vlera në lek e inputeve, është 4, 7 miliardë lekë. Në 2019-ën, po për nëntëmujorin, 110 mijë ton në peshë neto, rreth 4

miliardë lekë. Tashti, mund të kenë ndodhur dy gjëra. Heqja e TVSH-së mund të ketë ndihmuar që të përdorim më shumë inpute. Sepse sasia është pozitive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fillimisht sasia.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sasia është rritur 10 % më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulja e çmimit.

Bledi Çuçi – Domethënë, përveç uljes së çmimit, kontrabanda...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, sigurisht, sepse ajo ishte një masë që merrej edhe për këtë shkak.

Ilir Beqaj – Në qoftë se është ulur kontrabanda, bujqësia ka fituar vetëm te cilësia e mallit që kontrollohet. Në sasi hynte kontrabandë dhe shkonte prapë nëpër ara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e ka rrezikun.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ama, prapë shkonte në arë. Çmimi për njësi rezulton i rritur 4, 3 %. Po ta zbusim edhe me efektin e kursit, 7 %. Pra, mund të kemi marrë inputet më të mira.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledi Çuçi – Këtu jemi gjithmonë te tregu i jashtëm...

Ilir Beqaj – Jemi në doganë. Unë kam marrë të dhënat e doganës. I kam një për një, me muaj, me artikuj. Prapë kthehem tek ai merak: nuk u ndje sa ç'duhej, jo teorikisht patjetër me 1/6 e çmimit, sa ç'ishte pa TVSH, por ulja e TVSH-së ngeli më shumë te tregtari.

S'kemi ç'i bëjmë. E kemi pyetur Niko Lerën, qëkur e vumë: e merr përsipër çmimin? Çmimit s'kam ç'i bëj. Në qoftë se thoni se inputet tona janë të shtrenjta prej TVSH-së, ngelen prapë të shtrenjta edhe pa TVSH-në. Kjo është kontradikta.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Irfan Tarelli – Inputet janë fara, pesticide dhe plehra kimike. Përkthimi në tonazh, 110 mijë ton, fara, pesticidet, zënë një përmasë shumë të vogël.

Ilir Beqaj – Kush zë më shumë?

Irfan Tarelli – Më masivet janë plehrat kimike. Siç tha edhe ministri, farmacitë, janë pesticidet, farat më pak, sepse farat e kalojnë ciklin. Kur merret një furnizim me pesticide, ai nuk merret për një cikël, por merret për dy apo tre vjet. E vërteta është se këto farmaci kanë pasur probleme të mbartura nga çmimet e furnizimeve të mëparshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – E marrin mallin për tre vjet?

Irfan Tarelli – Për dy ose tre vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo për dy vjet, vitin që vjen do të jetë e reflektuar.

Sa për plehrat masive, ta garantoj me një milion për qind, se kanë reflektuar që të gjitha në çmimet. Pyet çdo lloj fermeri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Po, zoti Ministër!

Bledi Çuçi – E kemi pasur merak këtë gjë, sepse do të donim të impaktonte te fermeri masa fiskale që ne ndërmorëm këtu. Në muajin qershor, unë kam bërë një vëzhgim të tregut në lidhje me rreth 20 inpute bujqësore. Më ka rezultuar që kemi pasur çmime nga 12% deri në 20 % më të ulëta, sa u takon imputeve bujqësore. Tashti nuk i kam këtu të dhënat në lidhje me ato njëzet inpute, por mund t’jua dërgoj. Ne ngritëm një grup në të gjithë Shqipërinë, pikërisht për të monitoruar këtë gjë. Kjo është e vetmja statistikë që kemi në lidhje me këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, le të fillojmë me përgjigjet, sepse disa prej tyre i përmbledhëm. Në lidhje me pyetjen e zotit Pëllumbi, sa i takon rendimentit, pa diskutim që këtë e kemi pasur një nga meraqet kryesore, kur kemi bërë politikat. Fakti që dy drejtime kryesore të mbështetjes i kemi dhënë në ngritjen e serrave dhe në forcimin e pikave të grumbullimit, ka pasur si synim pikërisht rritjen e rendimentit, për të qenë avantazhues në treg në lidhje me produktin.

Nuk diskutohet se çështja e rendimentit për të njëjtën tokë dhe trajtim, lidhet pastaj edhe me njohuritë e fermerit, sa i takon trajtimit të produkteve e kështu me radhë. Pa diskutim, këto janë gjëra që i bën ekstensionin, por sigurisht edhe trajnimet e fermerëve në lidhje me këtë. Ama, sot që flasim kemi një rritje të jashtëzakonshme të rendimentit, krahasuar me shumë vite përpara. Domethënë, për të njëjtën sipërfaqe toke prodhojmë shumë më tepër tani. Ky është fakt.

Lidhur me pyetjen tjetër: si ka qenë përdorimi i fondeve të IPARD-it? Si ministër, unë jam i kënaqur. Duke marrë parasysh që është një skemë, ku mënyra e aplikimit dhe e selektimit imponohet me rregulla strikte që vijnë nga Brukseli, që, pa diskutim, nuk janë shumë të lehta për t’u përthithur në përgjithësi nga vendasit dhe në veçanti nga fermerët, unë jam i kënaqur, sepse duke qenë se Serbisë, nga momenti kur ka bërë thirrjen e parë për IPARD-in deri në momentin e lidhjes së kontratës së parë i është dashur një vit e gjysmë, ne

këtë gjë e kemi bërë brenda nëntë muajve. Pra, në nëntë muaj ne lidhëm kontratën e parë, madje tamam i bien tetë muaj, po të marrim parasysh që fundi i janarit ishte fundi i datës së aplikimit. Kështu që mendoj se po ecim mirë.

Për t'iu bashkuar edhe përgjigjes së pyetjes së Besos: si mund të bëjmë ne të mundur që fermeri të ketë lehtësi në aplikim, sigurisht, AZHBR-ja nuk mund ta bëjë këtë gjë, sepse AZHBR-ja ka konflikt interesi, pasi do të duhet të përzgjedhë. Nuk mund ta bëjë ajo aplikimin dhe pastaj po ajo të gjykojë për aplikimin. Por ne kemi bërë disa takime nëpër rajone të Shqipërisë, ku kemi shpjeguar në detaje se si mund t'i qaseni fondit... Ajo mbetet pastaj edhe pjesë e tregut që mund të ketë, siç e thatë edhe ju vetë, se ka firma konsulente që mund t'i asistojnë. Por, e përsëris, kemi bërë takime në të gjithë Shqipërinë, ia kemi thënë, ua kemi zbërthyer të gjithë skemën: çfarë dokumentacioni duhet, si duhet, çfarë ju bën legjitimë për të aplikuar e të tjera.

Kjo ishte edhe për pyetjen e zotit Barajt.

Në mos gabo, pyetja e Altinit, i cili nuk është prezent, ishte për akcizën e naftës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull, e kalojmë.

Për pikat e grumbullimit, për nxitjen e kooperimit dhamë përgjigje.

Sa ishte impakti i TVSH-së, e thamë për pjesën e inputeve, ndërsa lidhur me rimbursimin në pikat e grumbullimit janë gjithnjë debatet se si duhet orientuar subvencioni, pra duhet të ulim TVSH-në e rimbursueshme apo duhet t'ia japim direkt fermerit.

Në lidhje me blegtorinë, pra me qumështin, e bëmë me subvencion të drejtpërdrejtë te fermeri në bazë të lidhjes...

Te pjesa e prodhimeve të fruta-perimeve është disi më e vështirë, sepse qumështi ka një çmim dhe një treg më të stabilizuar për sa i përket çmimit, sesa fruta-perimet, pasi këto të fundit lidhen shumë me sezonin dhe është krejtësisht e pakontrollueshme; është një konjunkturë që ndryshon përditë. Bie fjala, domatja sivjet (më duket se ti e the pjesën që u ngroh për shkak të ngrohjes globale, që pati një superprodhim, fusha zgjati shumë, në serrë u dogj prodhimi), domethënë të gjitha katet e domates u rritën menjëherë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se do të rriteshin në pesë ditë nga 100 mijë, u rritën 500 mijë brenda ditës. Kjo bëri që të kishte një superprodhim, në një kohë kur çmimi ishte shumë i ulët, gjë që pastaj solli probleme me domaten.

Te domatja duhet thënë që është e njëjta gjë: duhet kapur tregu, duhet njohur tregu shumë, duhet bërë planifikimi në fermë. Ata që mbjellin në serrë, nuk duhet ta mbjellin në

korrik domaten, por në gusht, në mënyrë që vjeljen ta fillojnë në nëntor dhe të shesin e të kapin tregun. Por ata duan ta mbjellin në korrik, sepse duan ta zbrazin serrën në tetor, në mënyrë që ta mbjellin kastravecën sa më shpejt që në fillim të shkurtit ta kapin çmimin e kastravecit me 1300 lekë. Por, po të bëhet një planifikim i mirë, mund të kapin edhe çmimin e domates, edhe çmimin e kastravecit. Këto janë gjëra, po të fusësh këtu edhe konjunkturën e motit, që nuk i parashikon dot njeriu sot për sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e parashikonte dot njeri që në qershor dhe në fillim të korrikut se do të bënte këtë që bëri, ndryshe Venecia nuk do të ishte përmbytur. Këto janë gjëra që lidhen edhe me një konjunkturë që është ekstra humane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj është bujqësi dhe, pa diskutim, e vështirë.

Folëm për mollën. Duhet kapacitetet që të subvencionohet direkt në bazë, në prodhim. Është ajo që ne bëjmë pak a shumë me blegtorinë, se atë bëjmë me blegtorinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi arritur ende në këtë pikë, ndërkohë po të them një gjë: nga të gjithë ekspertët, kemi një *paper* të fundit nga një ekspert danez, që e ka kontraktuar FAO, i cili thotë se Europa po heq dorë nga subvencioni i drejtpërdrejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithsesi, edhe këtë vit ne do të përqendrohemi te blegtoria me paratë që kemi. Po të kishim më shumë, pa diskutim që do të aplikonim një skemë.

Ne i kemi të qarta skemat e subvencionimit të drejtpërdrejtë. Ndërkohë, ju them se po punojmë seriozisht për të ngritur një sistem për kontrollimin e çmimit të naftës në bujqësi. E them për të kontrolluar, pasi do të ngremë një sistem, ku, në varësi të politikave që do të ndjekim në vijim, do të duam që ta heqim taksën e qarkullimit për fermerët; ta heqim akcizën për fermerët, madje t'i heqim të dyja bashkë, për fermerin e kështu me radhë...

Ne do të jemi komodë për ta bërë brenda ditës këtë gjë, por kjo gjë kërkon ngritjen e një sistemi për ta bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po punoj që vitin tjetër ne ta kemi një sistem të tillë nëpërmjet kartës elektronike të fermerit...

Kontrolli, pra, është e gjitha. Ky është sistemi që do të bëjë kontrollin. Pastaj është në varësi të politikave që do të ndjekim se sa do t'ia lëmë fermerit çmimin e naftës. Ky mund të jetë pastaj një kontribut i drejtpërdrejtë për fermerin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Faleminderit!

Në qoftë se nuk ka pyetje e diskutime të tjera, unë dua të them vetëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Berti, kërkon fjalën? Urdhëro!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shartimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, faleminderit, zoti Ministër!

Unë dua të them diçka që e kam thënë këtu në komision dhe në pozicionin tuaj. Mirë është që të vërtetat t'i themi, domethënë ta njohim vërtet realitetin. E vërteta është që qeveritë shqiptare nuk kanë pasur dot mundësi të mbështesin më shumë se 5% të fermerëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse kërkon buxhete shumë të mëdha dhe këtu, mbi të gjitha, ne kemi trashëguar një hartë të tmerrshme të ndarjes së tokës. E kemi thënë, e dinë të gjithë, madje edhe fëmijët tani, se ne kemi qindra, mijëra fermerë me shumë pak tokë. Si do të shkojë politika e qeverisë deri tek ata? Me përjashtim të dy projekteve të ujitje-kullimit, që është e vërtetë se janë dyfishuar dhe më shumë se kaq (ujitja dhe kullimi), por edhe ajo që tha zoti Beqaj që sfida është te kanalet e treta; aty është tamam e vërtetë kjo që sapo the, Ilir, pra duhet të bëjnë edhe ndonjë gjë vetë.

Realisht, ta shikosh projektin e Bankës Botërore, që po vazhdon për Lushnjën e Fierin, të realizuar në mënyrë të shkëlqyer, e kanë ujin fare afër dhe nuk është ende edukata, kultura që të investojë për ta çuar ujin te parcela e tij, këtu pastaj nuk ke çfarë t'i kërlesh qeverisë.

Edhe për bashkitë do t'ju inkurajoja që ta vazhdonit ta thellonit decentralizimin. E di që Irfani është kundër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, është kundër në kuptimin që është skeptik për mënyrën e menaxhimit të skemave ujitëse nga bashkitë. Por nuk jam dakord me atë që u tha këtu që meqenëse ato votohen një herë në katër vjet, e bëjnë më keq punën. Edhe ne një herë në katër vjet votohemi, ndërsa kryetarin e bashkisë ke mundësi ta kapësh nga xhaketa çdo ditë, ndërkohë që ne nuk na kap dot kollaj.

Ata tentojnë të jenë më të përgjegjshëm, në kuptimin më të ekspozuar ndaj presionit të komunitetit, në këtë rast të fermerëve. Rreth 5%, në vlerësimin tim, le ta kem gabim,

marrin mbështetje të drejtpërdrejtë nga ne. Rreth 5% e bujqësisë është bujqësia që kanalizohet drejt pikave të grumbullimit, eksportit e të tjera. Ne flasim shumë për pika grumbullimi, pasi gjëja më e mirë që ka bërë qeveria jonë është shtimi i këtyre pikave, por, gjithsesi, jemi këtu te 5%-shi. Çfarë ndodh me 95% të bujqësisë, që prodhohet, tregtohet me forcat e saj te rruga nacionale, nëpër tregje e me radhë? Ndaj, dua ta mbështes ministrin në atë që tha, se absolutisht heqja e taksës, e TVSH-së, së inputeve bujqësore, është më minimalja që ne duhet ta kishim bërë me kohë, pasi është e vetmja masë që i mbështet të gjithë fermerët horizontalisht. Pra, edhe ai që ka një bahçe me mollë apo me kumbulla, edhe ai që ka dhjetëra hektarë (dhjetëra hektarë këtu nuk ka, ka shumë pak, por ka ferma të mëdha që përfitojnë njëlloj), jam i sigurt se në vite do ta japë impaktin edhe në muaj në çmim, sepse, siç e tha Iliri, i cili e njeh më mirë sektorin edhe nga ana e biznesit, kanë pasur furnizime, të cilat i kanë kapur me TVSH, kështu që do t'i shesin me çmim të lartë. Pra, do pak kohë derisa të reflektohet, por është gjëja e duhur, sado përsëri nuk është e mjaftueshme.

Kam një pyetje: pse nuk u fol shumë për politikat e tjera, të cilat nuk e çojnë prodhimin tek tregu, por çojnë këtë të fundit te prodhimi? Sepse këtë 95%-shin nuk e kap dot me pika grumbullimi. Edhe sikur t'i tridhjetëfishojmë pikat e grumbullimit, nga 5% do të shkojmë në 7%-8%. Pjesa e luanit ngelet e paaksesueshme, e pakapshme nga pikat e grumbullimit. Për shembull, në zonën e Korçës (që është fusha e dytë bujqësore më e madhe në Shqipëri) kemi frigoriferë për mollën, sepse molla e ka masën kritike që i jep fizibilitet këtij lloj biznesi, pra grumbullimit, por të gjitha produktet e tjera, qofshin edhe frutore, që, imagjinoni, e di Iliri, 30% e prodhimit të frutave të të gjithë Shqipërisë prodhohet në rajonin e Korçës; e kemi bërë një herë këtë diskutim, pra vetëm për mollën ka pika grumbullimi, frigoriferë, ndërsa për frutat e tjera të zonës nuk ka dhe, absolutisht, asnjë për perimet e zonës. Pse? Sepse nuk ka masë kritike, ka parcela të vogla, nuk ka konkurrueshmëri, nuk ka volume të eksportohen. Pra, nuk janë te pjesa e 5%-shit të përkëdhelur të bujqësisë. Të përkëdhelur, sepse, për sa kohë që është në të gjithë fjalorin tonë të ministrisë, të qeverisë, të deputetëve pika e grumbullimit, eksporti ose rimbursimi i TVSH-së e të tjera, ata quhen pjesa e përkëdhelur, sepse janë 5%-shi, ndërsa në pjesën e 95%-shit nuk kemi arritur dot t'i japim qoftë një NIPT fermerit për shkak të mentalitetit dhe të psikologjisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe ai është një problem i mbartur, pasi nuk është aq kollaj, sepse kërkon dhjetëra miliona euro investim që të realizohet, megjithëse zgjidhja që kemi bërë vitet e fundit është e mirë. Pra, për këtë duhet të jemi më të shqetësuar.

Programi “100 fshatrat” dhe agroturizmi janë disa programe të pjesës së zhvillimit rural që i qasemi nga e kundërta: në vend që të çojmë prodhimin tek tregu, çojmë tregun te fermeri, te prodhimi. Të çosh prodhimin tek tregu është ngjarje e pamundur. Për shembull, të çosh domatet e Korçës te pikat e grumbullimit dhe tek eksporti, është ngjarje e pamundur, për shkak të specifikave të tregut: konkurrueshmërisë, llojit të prodhimit, i cili nuk shkon dot në eksport e të tjera. Ndërsa në qoftë se e çon, po themi, agroturizmin në një zonë, po marrim Korçën (sado për të qenë korrektë duhet të marrim edhe zona të tjera, ja edhe Gjirokastrën), i ke çuar tregun.

Edhe programi “100 fshatrat”, që nuk dëgjova të jetë në fokus...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse, more?! Gjirokastra thashë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ah, e bëre Jug-Veri tani! Mos na fut aty!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shkodra...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë faleminderit që ma ndërpretë fjalën!

E mbarova, se nuk thashë ndonjë gjë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, unë nuk po them gjë tjetër!

Ilir Beqaj – Jam 100% dakord me ty, por nuk është 5%, është shumë më e madhe.

Niko Peleshi – Cili 5%, sepse unë përmenda disa? Përmenda përqindjen e bujqësisë që eksportohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po 95%.

Ilir Beqaj – Në qoftë se eksporti është më shumë se 10% e vlerës së prodhimit, eksporti nuk bëhet më.

Niko Peleshi – Nuk është më shumë se 10%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në bujqësi? Prodhim bujqësor? Është 5%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është 2,2 miliardë bujqësia, more burrë, si volum!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Çfarë...

Niko Peleshi – 2,2 miliardë euro.

Ilir Beqaj – Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Eksporti i prodhimeve bujqësore?

Ilir Beqaj – Ai pjesë e asaj është.

Niko Peleshi – Jo agropërpunues, por prodhim bujqësor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agropërpunimi nuk është vetëm me prodhim vendas.

Ilir Beqaj – Si?

Niko Peleshi – Nuk është vetëm me lëndë të parë vendase.

(Deputeti Beqaj flet gjatë gjithë kohës pa mikrofon.)

Po flasim për bujqësinë, se për blegtorinë është histori tjetër. Çoje 20. Po 80%-shi?

Robert Bitri – Është shumicë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Si 35? Pjesa që mbetet? Ah, pjesa që ndihmohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Të gjitha skemat, përveç inputit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Ilir, ta marrim ndryshe? Me numër fermerësh, sa për qind...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shumë faleminderit!

Mbaruam edhe me ministrinë tuaj.

Përgëzime dhe suksese!

MBYLLET MBLEDHJA